



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2024

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.158, DATË 26.12.2019, TË
KËSHILLIT BASHKIAK, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
NË QYTETIN E TIRANËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar, vendimit nr.132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, vendimit nr. 701, datë 18.11.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021-2025", vendimit nr. 216, datë 13.4.2023, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim", udhëzimit nr. 6, datë 11.04.2022 të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për mjetet që përdoren për peshkim çlodhës-argëtues dhe mënyrën e lëshimit të autorizimit", urdhrin të përbashkët nr. 443, datë 6.10.2022 të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përcaktimin e tarifave të autorizimit për peshkimin çlodhës-argëtues dhe tarifave për shërbimet që ofrohen nga organizata e peshkimit" dhe Memo-t me nr. 45218 datë 28.12.2023 dhe nr. 4039 datë 24.01.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 6 "Çmimi mesatar referues për përlllogaritjen e taksës", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a. Aneksi i përcaktuar në pikën 1, ndryshohet me aneksin me të njëjtën numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

b. Në pikën 2, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) përqind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas njësive administrative të Bashkisë Tiranë.”

c. Në pikën 2, shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrikat, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshirë ato të njësive të tregimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) përqind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zones përkatëse, sipas njësive administrative të Bashkisë Tiranë. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura”.

d. Në pikën 2, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f” me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“f. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, do të indeksitet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëngjitet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

2. Në nenin 8 “Lehtësira dhe përjashtimet nga taksa e ndërtesës” pas pikës 11, bëhet kjo shtesë:

1. Lehtësohen nga taksa e ndërtesës në masën 30% bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët dhe për ato biznese, në të cilat numri i të punësuarve romë dhe egjiptianë zë mbi 30% të numrit total të të punësuarve në atë biznes”, vetëm pasi përfaqësuesi i subjektit juridik depoziton një deklaratë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore ku deklaron se biznesi është krijuar ose ka të punësuar mbi 30% romë dhe egjiptianë, duke përcaktuar dhe Njësitë Administrative/Lagjet ku janë të regjistruar. Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pas administrimit të kësaj deklarate mban korrespondencë me Njësitë Administrative/Lagjet për të kryer verifikimet përkatëse, me qëllim që këto subjekte të përfitojnë nga lehtësitë fiskale sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në nenin 23, “Baza dhe niveli i taksës”, bëhen këto ndryshime:

a. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Niveli i taksës në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t’u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit si edhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.

b. Në shkronjën “a”, të pikës 3, togfjalëshi “të bujqësisë” hiqet.

c. Në pikën 3, pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me përmbajtje si më poshtë:

“a/1. Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor e blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 2 (dy) për qind e vlerës së investimit”.

d. Në pikën 3, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “e” me përmbajtje si më poshtë:

“e. Për subjektet që janë në proces aplikimi për t’u pajisur me leje ndërtimi për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 2 (dy) për qind e vlerës së investimit”.

4. Në nenin 38 , “Lehtësira dhe përjashtime” bëhet ky ndryshim:

a. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Lehtësohen nga taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore në masën 50% bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët dhe për ato biznese, në të cilat numri i të punësuarve romë dhe egjiptian zë mbi 30% të numrit total të të punësuarve në atë biznes”, vetëm pasi përfaqësuesi i subjektit juridik depoziton një deklaratë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore ku deklaron se biznesi është krijuar ose ka të punësuar mbi 30% romë dhe egjiptianë, duke përcaktuar dhe Njësitë Administrative/Lagjet ku janë të regjistruar. Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pas administrimit të kësaj deklarate mban korrespondencë me Njësitë Administrative/Lagjet për të kryer verifikimet përkatëse, me qëllim që këto subjekte të përfitojnë nga lehtësitë fiskale sipas legjislacionit në fuqi.”

5. Në nenin 40 “Llojet e tarifave”, bëhet kjo shtesë:

a. Pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj. Tarifa për aplikimin e peshkimit argëtues- çlodhës amator”

6. Në nenin 41 “Tarifa e pastrimit”, bëhet shtesa dhe ndryshim si më poshtë:

a. Aneksi i përcaktuar në pikën 2, ndryshohet me aneksin me të njëjtën numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

b. Pas pikës 2, shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:

“3. Kategorizimi i tarifës së pastrimit sipas nivelit të xhiros vlen vetëm për subjektet pa përgjegjësi tatimore të “Tatim mbi fitimin”.

7. Në nenin 42 “Mënyra e pagesës së tarifës së pastrimit”, bëhet ky ndryshim:

a. Pika 6, ndryshohet si më poshtë:

“6. Për kategorinë II. “Subjekte Ndërtimi” nënkategoritë:

i. “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to”, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për certifikatë përdorimi pranë Bashkisë së Tiranës. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë investime publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit. Për çdo rast tjetër “Rikonstruksioni të pjesshëm”, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me proces verbalin e dorëzimit të punimeve dhe procesverbalin nga sektori i verifikimit në terren.”

ii. “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to, rikonstruksione të pjesshme të ngjashme me to, për të cilat miratohet leje ndërtimi por nuk vihet në shfrytëzim/zbatim nga zhvilluesi/ndërtuesi deri në përfundim të afatit të lejes, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me procesverbalin nga sektori i verifikimit në terren.”

iii. “Punime në fushën e ndërtimit” si më poshtë:

-“Lejet e ndërtimit për prishje objekti” kryesisht me afat 3-6 mujor, me përfundimin e të cilave miratohet “Leja e ndërtimit për objekt banimi + shërbim” me periudhë tarifimi afatin e vlefshmërisë së lejes në fjalë ose periudha nga zbardhja e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me procesverbalin nga sektori i verifikimit në terren”

- “Lejeve për ndërtim muri rrethues” me periudhë tarifimi afatin e vlefshmërisë së lejes në fjalë ose periudha nga zbardhja e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me procesverbalin e dorëzimit të punimeve dhe procesverbalin nga sektori i verifikimit në terren”.

8. Në nenin 43, “Lehtësira dhe përjashtime” bëhet kjo shtesë:

a. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtjen si më poshtë:

“3. Lehtësohen nga tarifa e pastrimit në masën 50% bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët dhe për ato biznese, në të cilat numri i të punësuarve romë dhe egjiptian zë mbi 30% të numrit total të të punësuarve në atë biznes”, vetëm pasi përfaqësuesi i subjektit juridik depoziton një deklaratë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore ku deklaron se biznesi është krijuar ose ka të punësuar mbi 30% romë dhe egjiptianë, duke përcaktuar dhe Njësitë Administrative/Lagjet ku janë të regjistruar.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pas administrimit të kësaj deklarate mban korrespondencë me Njësitë Administrative/Lagjet për të kryer verifikimet përkatëse, me qëllim që këto subjekte të përfitojnë nga lehtësitë fiskale sipas legjisllacionit në fuqi”.

9. Në nenin 48 “Lehtësira dhe përjashtime”, pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtjen si më poshtë:

“4. Lehtësohen nga tarifa për zënien e hapësirës publike në masën 50% bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët dhe për ato biznese, në të cilat numri i të punësuarve romë dhe egjiptianë zë mbi 30% të numrit total të të punësuarve në atë biznes vetëm pasi përfaqësuesi i subjektit juridik depoziton një deklaratë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore ku deklaron se biznesi është krijuar ose ka të punësuar mbi 30% romë dhe egjiptianë, duke përcaktuar dhe Njësitë Administrative/Lagjet ku janë të regjistruar. Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pas administrimit të kësaj deklarate mban korrespondencë me Njësitë Administrative/Lagjet për të kryer verifikimet përkatëse, me qëllim që këto subjekte të përfitojnë nga lehtësitë fiskale sipas legjisllacionit në fuqi.

10. Në nenin 58, “Baza, niveli dhe përlllogaritja e tarifës”, bëhet ky ndryshim:

a. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për leje ndërtimi tarifa është në vlerën 1 përqind e vlerës së investimit. Vlera e investimit llogaritet sipas preventivit të investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar, të hartuar sipas sistemit të integruar të informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

11. Neni 59 “Tarifa për Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, ndryshohet si më poshtë:

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, aplikon këto tarifa:

1. Për dhënie në përdorim të ambienteve të Amfiteatrit 10,000 lekë/ora;
2. Tarifat për dhënie në përdorim të ambienteve të “Reja-s” për aktivitete biznesi (edukative, kulturore dhe artistike) 20,000 lekë/ora për aktivitete biznesi; 5,000 lekë/ora për aktivitete edukative, kulturore dhe artistike.
3. Çmimi i biletës për trenin Panoramik, tek kendi i lojrave ne hyrje te liqenit, për fëmijët e moshës 0 -15 vjeç është 50 lekë dhe për fëmijët e moshës mbi 15 vjeç është 100 lekë.
4. Çmimi i biletës për varkën vozitëse në liqeni 500 lekë/ora;
5. Për përdorimin e ambienteve të godinave të Tirana Olimpik Park nga personat e tretë niveli i tarifave është si më poshtë:
 - a. Aktivitete të ndryshme sportive në sallën e pallatit të sportit, 12,000 lekë/ora.
 - b. Aktivitete të ndryshme sportive për grupe të rinjsh në sallën e pallatit të sportit 10,000 lekë/ora
 - c. Aktivitete të ndryshme sportive për grupe amatorë/shkolllore jopublike, 9,000 lekë/ora
 - d. Aktivitete të ndryshme sportive mbi një ditë, 100,000 lekë/dita

- e. Organizime të ndryshme fetare, kulturore, politike në sallën e pallatit të sportit, 120,000 lekë/dita.
 - f. Aktivitete të ndryshme të organizuara në hollin e pallatit të sportit, 30,000 lekë/dita
 - g. Salla e konferencave, 15,000 lekë/aktiviteti paradite
 - h. Salla e konferencave, 20,000 lekë/aktiviteti pasdite
 - i. Salla e konferencave për një ditë, 25,000 lekë/dita
6. Tarifat për dhënien në përdorim të fushave sportive në Parkun e Madh të Liqenit Artificial:
- a. Fusha e tenisit “Perlat Vushtina” (PMLAT):
 - tarifë për përdorimin e e fushës së tenisit 1,000 lekë/kohëzgjatja 60 min”.
 - b. Fusha e volejbollit (PMLAT):
 - tarifë për individ/grup individësh 1,400 lekë/kohëzgjatja 60 min;
 - tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2,000 lekë/kohëzgjatja 60 min.
 - c. Fusha e basketbollit (PMLAT):
 - tarifë për individ/grup individësh 1,300 lekë/kohëzgjatja 60 min;
 - tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2,000 lekë/kohëzgjatja 60 min.
 - d. Fusha e futbollit bar natyral (PMLAT):
 - tarifë për individ/grup individësh 2,000 lekë/kohëzgjatja 90 min;
 - tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2,500 lekë/kohëzgjatja 90 min”.
7. Tarifat për dhënien në përdorim të Fushës Sportive të Futbollit Laprakë”:
- tarifë për individ/grup individësh 5,000 lekë/kohëzgjatja 90 min;
 - tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 6,000 lekë/kohëzgjatja 90 min;
12. Në nenin 61, “Lehtësira dhe përjashtime”, bëhet ky ndryshim:
- a. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përjashtohen nga detyrimi për të paguar çmimin e biletës për Trenin Panoramik tek këndi i lojrave në hyrje të liqenit, fëmijët me aftësi të kufizuara.
13. Në nenin 64 “Tarifa për kopshtet dhe çerdhet”, shkronjat “a” dhe “b”, ndryshohen si më poshtë:
- “a. 170 lekë për fëmijë në kopshte”
 - “b. 150 lekë për fëmijë në çerdhe”
14. Në Kreun VIII “Tarifa të Institucioneve të Varësisë”, shtohen nenet si më poshtë vijon:

Neni 69/1

Tarifat për Kopshtin Zoologjik

Biletat për hyrjen në kopshtin zoologjik, janë të ndara sipas kategorive më poshtë:

- Për të rritur 300 lekë/person
- Grupmosha 3 deri në 18 vjeç 150 lekë/person
- Pensionist 150 lekë/person
- Për grup mbi 10 persona 100 lekë/person
- Persona me aftësi të kufizuara, pa pagesë

Neni 69/2
Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik dhe sipas akt akordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

Neni 69/3
Tarifat për biletat e kinemasë “Agimi”

Tarifat për biletat e kinemasë “Agimi”, do të jenë si më poshtë:

- a) Biletë Individuale në orarin (09:00-12:00) 400 lekë;
- b) Biletë Individuale në orarin (12:00-20:00) 500 lekë;
- c) Biletë Individuale në orarin (20:00-00:00) 400 lekë;
- d) Biletë për fëmijët e arsimit 9-vjeçar 100 lekë;
- e) Biletë për studentët (të pajisur me kartën e studentit) në masën 50%;
- f) Biletë për personat e moshuar 200 lekë;

Neni 69/4
Tarifat për dhënien në përdorim të sallave në kinemanë “Agimi”

Tarifat për dhënien në përdorim të sallave në kinemanë “Agimi”, për aktivitete të ndryshme, të llogaritura në orë, ditë apo javë, në varësi të aktivitetit dhe programit përkatës që mbulon aktivitetin, janë si më poshtë:

- a) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e madhe (Evente të klientëve, evente kompanie, prezantime produkti, konferencë, leksione, seminare, kurse) 5,000 lekë/orë;
- b) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e vogël (Evente të klientëve, evente kompanie, prezantime produkti, konferencë, leksione, seminare, kurse) 1,000 lekë/orë;
- c) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e madhe (Ekspozitë, shfaqje private, filma premiere, evente festive, aktivitete komunitare) 20,000 lekë/ditë;
- d) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e vogël (Ekspozitë, shfaqje private, filma premiere, evente festive, aktivitete komunitare) 10,000 lekë/ditë;
- e) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e madhe (Muze) 100,000 lekë/javë;
- f) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e vogël (Muze) 40,000 lekë/javë;

Neni 69/5
Përjashtime

1. Përjashtohen nga pagesa e tarifës për biletat e kinemasë “Agimi” kategoritë e mëposhtme:
 - Të sëmurë tetraplegjikë dhe paraplegjikë sipas vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë
 - Personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit 93/2014

- Delegacione zyrtare shtetërore.
2. Përfshihen nga pagesa e tarifës për marrjen në përdorim të sallave të kinemasë “Agimi” kategoritë e mëposhtme:
- Subjektet që zhvillojnë aktivitetet me interes publik për qëllime sociale apo misionë bamirësie
 - Nisma të Bashkisë Tiranë, ente arsimore publike
 - Aktivitetet e organizuara për shtëpine e fëmijës “Zyber Hallulli”

Neni 69/6

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës

Struktura, e cila do të ngarkohet për mbledhjen e tarifave të parashikuara në nenin 69/3 dhe 69/4 të këtij Kreu, do të jetë Agjencia e Industrisë Kreative Tiranë dhe sipas akt-rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, do të kalojë të ardhurat 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

15. Mbas Kreut XV, shtohet Kreu XV/1 “Tarifa për aplikimin e peshkimit argëtues- çlodhës”, si më poshtë:

KREU XV/1

“TARIFA PËR APLIKIMIN E PESHKIMIT ARGËTUES- ÇLODHËS AMATOR”

Neni 77/1

Autorizim për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit

1. Të gjithë personat fizikë, vendas ose të huaj, anëtarë të shoqatave kombëtare të peshkimit argëtues-çlodhës që ushtrojnë apo kërkojnë të ushtrojnë aktivitet peshkimi në territorin e bashkisë Tiranë duhet të pajisen me autorizim për ushtrimin e këtij aktiviteti.
2. Autorizimi lëshohet nga struktura përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, e cila caktohet me urdhër kryetari.
3. Kërkesa për t’u pajisur me autorizim për peshkimin amator dhe nënujor bëhet online në portalin e-Albania, në e-Shërbime, në hapësirën “Aplikim për t’u pajisur me autorizim për peshkim çlodhës-argëtues”, duke plotësuar formularin e kërkesës dhe duke ngarkuar dokumentacionin përkatës. Autorizimi lëshohet nëpërmjet portalit e-Albania, brenda 3 (tre) ditëve pune, pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve teknike.
4. Autorizimi për peshkimin amator përdoret vetëm prej personit, në emër të të cilit është lëshuar.
5. Mbajtësi i autorizimit, gjatë ushtrimit të aktivitetit çlodhës - argëtues, është i detyruar të mbajë gjithmonë me vete autorizimin përkatës, si dhe t’ua tregojë atë personave të autorizuar në bazë të këtij ligji, me kërkesën e parë.
6. Për tu pajisur me autorizimin e sipërcituar, nevojitet ngarkimi në portalin e-albania i dokumentave të mëposhtëm:
 - a) fotografi të aplikantit
 - b) vërtetim anëtarësie në një shoqatë kombëtare të peshkimit çlodhës-argëtues
 - c) mandat-pagesa që vërteton pagesën e tarifës.

Neni 77/2

Tarifa dhe vjelja e saj

1. Tarifa për “Peshkimin amator në ujëra të brendshëm” është 1,000 lekë/vit.
 2. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe sipas akt akordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.
- 16.** Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Agjencia e Industrisë Kreative, Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO

Aneksi 1: Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Tiranë

Bashkia Tiranë	Nr. Njesisë Administrative	Nr. Rendor	Zona	Lekë/m2 sipërfaqe Shfrytëzimi
Qyteti Tiranë sipas ndarjeve zonale për çdo njësi administrative	1	1	1/1	102,800.00 Lekë
		2	1/2	97,200.00 Lekë
	2	3	2/1	202,400.00 Lekë
		4	2/2	148,400.00 Lekë
		5	2/3	110,600.00 Lekë
		6	2/4	120,300.00 Lekë
		7	2/5	85,700.00 Lekë
	3	8	3/1	98,500.00 Lekë
		9	3/2	86,300.00 Lekë
	4	10	4/1	95,900.00 Lekë
		11	4/2	95,300.00 Lekë
	5	12	5/1	228,400.00 Lekë
		13	5/2	175,800.00 Lekë
		14	5/3	164,800.00 Lekë
		15	5/4	117,800.00 Lekë
	6	16	6	81,700.00 Lekë
	7	17	7/1	159,100.00 Lekë
		18	7/2	123,400.00 Lekë
		19	7/3	124,500.00 Lekë
		20	7/4	114,300.00 Lekë
	8	21	8/1	145,650.00 Lekë
		22	8/2	156,700.00 Lekë
		23	8/3	89,900.00 Lekë
	9	24	9/1	163,600.00 Lekë
		25	9/2	135,800.00 Lekë
		26	9/3	113,850.00 Lekë
	10	27	10/1	192,800.00 Lekë
		28	10/2	178,300.00 Lekë
		29	10/3	121,200.00 Lekë
	11	30	11/1	113,000.00 Lekë
		31	11/2	103,500.00 Lekë
		32	11/3	93,600.00 Lekë
Njësitë Administrative Bashkia Tiranë	12	33	Baldushk	32,000.00 Lekë
	13	34	Bërzhitë	34,000.00 Lekë
	14	35	Dajt	75,500.00 Lekë
	15	36	Farkë	115,200.00 Lekë
	16	37	Kashar	69,000.00 Lekë
	17	38	Kërrabë	28,200.00 Lekë
	18	39	Ndroq	34,000.00 Lekë

	19	40	Petrelë	85,800.00 Lekë
	20	41	Pezë	85,800.00 Lekë
	21	42	Shëngjergj	23,000.00 Lekë
	22	43	Vaqar	34,000.00 Lekë
	23	44	Zall-Bastar	25,000.00 Lekë
	24	45	Zall-Herr	28,200.00 Lekë

Aneksi nr. 6: Tarifa e pastrimit

Nr	Kategoritë	BV		BM	VIP
		Xhiro	Xhiro		
		0-2 milionë	2-8 milionë		
		Leke/vit	Leke/vit		
	FAMILJARËT (për Familje)				
I	Qyteti Tiranës	5,750			
	NJA = Dajt, Farkë, Kashar,	2,300			
	NJA = Berzhite, Baldushk, Petrele, Vaqarr, Pezë, Ndroq, Krabë, Shengjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar	1,150			
II	BIZNESI				
II.1	SHITJE ME PAKICË				
	Mish, peshk	5,750	11,500	92,000	115,000
	Bulmet, fruta, perime, ushqimore	5,750	11,500	69,000	93,150
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj të ngjashme me to).	5,750	11,500	34,500	57,500
	Bar kafe	5,750	11,500	69,000	92,000
	Restorant, fast food etj të ngjashme me to	5,750	13,800	85,100	108,100
	Pub, diskoteka etj të ngjashme	5,750	13,800	92,000	115,000
	Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti	5,750	11,500	23,000	43,700
	Njësi tregtimi lëndësh djegëse, hidrokarbure etj të ngjashme me to.	5,750	11,500	50,600	73,600

	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to (depo farmaceutike të regjistruara si biznes i vogël)	5,750	11,500	23,000	43,700
	Etj të ngjashme me to	5,750	11,500	23,000	43,700
II.2	SHITJE ME SHUMICË				
	Magazina, dyqane, etj të cilat realizojnë shitje me shumice	5,750	13,800	85,100	108,100
II.3	NJËSI PRODHIMI				
	Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj të ngjashme me to	5,750	11,500	195,500	414,000
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje, nyje inerte etj, të ngjashme me to	5,750	11,500	195,500	414,000
	Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj të ngjashme me to.	5,750	11,500	195,500	391,000
	Prodhim konfeksione, etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Prodhim, përpunim vajrash, nafte , gazi e nënprodukte etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Impiante, territore për therrjen e kafshëve etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Shtypshkronja etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	5,750	8,050	195,500	414,000
	Prodhim përpunim produkte farmaceutike etj të ngjashme me to.	5,750	8,050	195,500	414,000
II.4	SUBJEKTE NDËRTIMI				
	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to ,	5,750	34,500	345,000	517,500
	Njësi ndërtimi që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me	5,750	17,250	172,500	258,750

	sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike				
	Rikonstruksione të pjeshme	5,750	17,250	172,500	257,600
	Punime në fushën e ndërtimit	5,750	17,250	172,500	257,600
	Subjekte ndërtuese për selinë administrative	5,750	17,250	41,400	69,000
	Subjektet e Karrierave për prodhim guri, inerte etj të ngjashme me to,	5,750	17,250	115,000	115,000
II.5	NJËSI SHËRBIMI				
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofon, paisje fonie e të tjera te ngjashme me to.	4,000	11,500	57,500	69,000
	Shërbime fotokopjimit, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina,(autoshkolla) për traktore, për kompjuter e për parukeri, agjensi doganore,agjensi këmbimi valutë, agjensi turizmi,, konviktet pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkimi i makinave, agjenci transporti, lavanteritë,pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojrave të ndryshme,(gjimnastikë, aerobie, cirqe, kënde lojrash për femijë, ping pong, etj.) e të tjera shërbime të ngjashme me shërbimet e lartëpërmendura.	4,000	11,500	57,500	80,500
	Shtëpi botuese, biblioteka	5,750	11,500	57,500	80,500
	Hotele, motele (lekë/dhomë në vit)	5,750	11500	34,500	69,000
			1,150	1,725	2,300
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës,këpucar, floktore, orëndreqës etj	4,000	8,050	34,500	57,500
	Komplekse sportive, palestra, fitnes,pishina, qendra e institute kërkimore-shkencore,salla koncerte-mbledhje e videoteka	5,750	11,500	57,500	80,500
	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura	5,750	11,500	23,000	57,500

	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet, shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostifikimi	5,750	11,500	57,500	80,500
	Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)	5,750	11,500	34,500	57,500
II.6	SHOQATA, FONDACIONE, ENTE TË NDRYSHME SHTETËRORE, ORGANIZATA JOQEVERITARE	10,000			
II.7	PROFESIONE TË LIRA				
	Avokatët, noter,mjek, mjeku-laborant, stomatologu, farmacisti,ekonomisti kontabël te miratuar, eksperti kontabël te autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomët, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e të tjera profesione të lira te cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	5,750	11,500	34,500	57,500
	Galeritë e artit të piktoreve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	4,000	11,500	34,500	57,500
	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet),shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostifikimi etj në rastet kur nuk e kalojnë kufirin e regjistrimit nëTVSH.	5,750	13,800	57,500	80,500
II.8	AMBULANT				
	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private.	3,000			
II.9	TRANSPORT				
	Transport pasagjerësh				
	Automjet deri 5 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 6-9 vende	4,000	8,050	23,000	55,200

	Automjet 10-25 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 26-42 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet mbi 42 vende	4,000	8,050	23,000	55,200
	Transport Mallrash				
	Automjet deri 2 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 2-5 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 5-10 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet 10-16 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200
	Automjet mbi 16 tonë	4,000	8,050	23,000	55,200

RELACION

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.158, DATË 26.12.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS", TË NDRYSHUAR

Bashkia Tiranë me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fuqi për vendosjen e taksave dhe tarifave vendore, si dhe mbledhjen dhe administrimin e tyre, merr të gjitha masat e nevojshme për reflektimin e ndryshimeve që ka pësuar legjislacioni në fuqi dhe ndryshimin e paketës fiskale si pasojë e rritjes dhe shtimit të gamës së shërbimeve të ofruara për qytetarët në fusha të ndryshme.

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, në përputhje me detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tiranë, akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e përgjegjësisë së kësaj drejtorie, pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar propozimet për ndryshimet e taksave dhe tarifave në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar, (në vijim VKB 158/2019) ka propozuar disa ndryshime duke paraqitur dhe arsytet përkatëse.

Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre.

Objekt i projektvendimit që po ju paraqesim për miratim janë disa nga taksat dhe tarifat vendore që zbatohen në territorin e Bashkisë Tiranë lidhur me nivelin, procedurat e llogaritjes, baza tatimore, kategorizimet dhe nën kategorizimet, lehtësimet apo përjashtimet etj.

1. Taksa e Ndërtesës

Bazuar në vendimin nr.144, datë 13.02.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme 'ndërtesa', e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" të ndryshuar, vendim i cili ka bërë ndryshimin e Aneksit nr.2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.132, datë 07.03.2018 si dhe propozimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë me shkresë nr.8/58, datë 01.02.2023 për replikim të ndryshimeve të akteve ligjore dhe shkresës "Për trajtim" me nr.1379/2, datë 16.02.2023, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, propozohen dy ndryshime të Nenit 6 si më poshtë shpjeguar;

Vendimi nr. 144 ka ndryshuar 2 pika te Aneksit nr.2 përkatësisht pikat c dhe ç. Këto dy pika kanë ndryshime të tjera me Vendimin nr.457 datë 26.07.2023.

Vendimi 457 datë 26.07.2023 i cili ka ndryshuar Anekset 1 dhe 2 që i bashkëngjiten vendimit nr.132 datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave do të shtoj në nenin 6 “Çmimi mesatar referues për përlogaritjen e taksës pikën 2. f në vendimin e Këshillit Bashkiak 158/2019.

Konkretisht propozojmë këto ndryshime në VKB nr.158/2019, në Nenin 6 të ndryshohen pika 2 gërma c dhe d dhe të shtohet pika 2 gërma f.

Pika 2, gërma c nga:

“Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit, sipas Njësive Administrative.”

do të ndryshoj në:

“Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte aereporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) përqind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas Njësive Administrative të Bashkisë Tiranë.”

Pika 2, gërma d nga:

“Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zones përkatëse.”

Do të ndryshoj në:

“Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrikat, magazinat, depot, silos, magazinat frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshirë ato të njësive të tregimit dhe të shërbimit) , si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zones përkatëse, sipas Njësive Administrative të Bashkinë Tiranë.” Ne këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura”.

Pika 2, gërma f shtohet:

“Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin

0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëngjitet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

2. Lehtësira për bizneset Rom dhe Egjiptian

Bazuar në parashikimet e vendimit nr.701, datë 18.11.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e “Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025”, i cili kërkon nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrin masa për lehtësimin nga taksat dhe tarifat vendore mbi bizneset e ngritura nga Rom dhe Egjiptian në masën 50%.

Plani Kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, parashikon zbatimin e disa masave dhe nisjen e aktiviteteve të reja që do çojnë në nxitjen e integritit të romëve dhe egjiptianëve. Ky plan është hartuar në konsultim me ministritë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga komuniteti rom dhe egjiptian, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizata të shoqërisë civile si dhe me organizata ndërkombëtare të cilat punojnë për çështjet e integritit të Rom dhe Egjiptian në Shqipëri.

Qëllimet e politikës dhe objektivat specifike të këtij Plani Kombëtar vijojnë si më poshtë:

1. Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për Rom dhe Egjiptian.
2. Përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave romë dhe egjiptiane, si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve joformale.
3. Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis romëve dhe egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë.
4. Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për Rom dhe Egjiptian në të gjitha nivelet arsimore.
5. Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët.
6. Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të Romëve dhe Egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale.
7. Antixhopsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistematike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj Romëve dhe Egjiptianëve.

Referuar pikës 5 në lidhje me krijimin e mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për Rom dhe Egjiptian janë trajtuar disa objektiva.

Specifikisht objektivi nr.2 lidhet me nxitjen e sipërmarrjes (sociale) dhe vetëpunësimin e Romëve dhe Egjiptianëve, që ka si qëllim përfshirjen e target-grupeve të sipërcituara në krijimin e ndërmarrjeve sociale si dhe marrjen e masave për nxitjen e punësimit të tyre.

Në këtë plan parashikohet që deri në fund të 2025, të paktën 300 Rom dhe Egjiptian të mund të mbështeten financiarisht për sipërmarrjen dhe vetëpunësim me qëllim akomodimin e tyre në ekonominë formale. Një ndër këto objektiva lidhet me skemat për garantimin e vetëpunësimit që ka në fokus ofrimin e granteve të vogla apo kredive të buta si dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse apo krijimin e lehtësirave fiskale si ulja e taksave apo e tarifave vendore për bizneset.

Referuar funksioneve të Bashkisë Tiranë për të mbështetur minoritetet dhe target-grupet që nuk marrin përkrahje si dhe me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fuqi për vendosjen e taksave vendore si dhe shtimin e gamës së shërbimeve të ofruara për qytetarët në fusha të ndryshme, krijon domosdoshmërinë e krijimit të disa lehtësirave fiskale për kategorinë e Romëve dhe Egjiptianëve që ushtrojnë veprimtari ekonomike.

Për të përmbushur objektivat në bashkëpunim me DPSHS është e rëndësishme marrja e masave si më poshtë:

- të ulen taksat në masen 50% për ato biznese, të cilat numri i të punësuarve romë dhe egjiptianë zënë mbi 30% të numrit total të të punësuarve në atë biznes.
- përjashtimi ose reduktimi nga tarifat për ambulantët romë dhe egjiptian, që tregtojnë produkte artizanale ose mallra të tjera;
- rezervim i hapësirave të caktuara tregtare dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për t'u përdorur nga Rom dhe Egjiptian.

Përsa i përket detyrimeve fiskale, Bashkia Tiranë ka parashikuar në VKB nr.158, datë 26.12.2019, "Për Miratimin e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës", i ndryshuar, të gjitha taksat dhe tarifat vendore si më poshtë referuar subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike:

- 1) Taksa e ndërtesës; - deri në 30% mund të bëhet ulja e detyrimit nëse merret vendimi për lehtësimin nga kjo taksë, duke qenë se kjo taksë është e rregulluar nga ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 12 "Rregulla të përbashkëta për taksat vendore", pika 5. Për taksën e pasurisë së paluajtshme, këshilli bashkiak vendos nivelin e taksës në kufijtë plus 30 për qind dhe minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.
- 2) Tarifa e pastrimit në varësi të llojit të aktivitetit që ushtron subjekti ka tarifim të ndryshëm.
Tarifa e Pastrimit për kategorinë: - Ambulant 3,000 lekë/vit
- 3) Tarifa për Zënien e Hapësirës Publike për qëllime biznesi/ tregtimi në Tregjet Publike të administruara nga Njësitë Bashkiake:

- Zona A	1500 ALL/m ²
- Zona B	750 ALL/m ²
- Zona C (Qyteti Tiranë NJA, Dajt, Farkë, Kashar)	400 ALL/m ²
- NJA Bërzhitë, Baldushk, Petrelë, Vaqarr, Pezë	200 ALL/m ²

Ndroq, Krabë, Shëngjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar

- 4) Në lidhje me Taksën e përkohshme të Infrastrukturës arsimore është miratuar ulja e detyrimit për këtë kategori në masën 50% për bizneset e ngritura nga Rom dhe Egjiptian dhe ato biznese që kanë të punësuar mbi 30% Rom dhe Egjiptian në bizneset e tyre.

Të shtohet vetëm pjesa e dokumentacionit dhe mënyra e administrimit të dokumentacionit nga DPTTV për përfitimin e lehtësimit e shprehur si më poshtë:

“vetëm pasi përfaqësuesi i subjektit juridik depoziton një deklaratë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore ku deklaron se biznesi është krijuar ose ka të punësuar mbi 30% romë dhe egjiptianë, duke përcaktuar dhe Njësitë Administrative/Lagjet ku janë të regjistruar. Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pas administrimit të kësaj deklarate mban korrespondencë me Njësitë Administrative/Lagjet për të kryer verifikimet përkatëse, me qëllim që këto subjekte të përfitojnë nga lehtësitë fiskale sipas legjislacionit në fuqi.”

Në lidhje me uljen e taksave dhe tarifave vendore, referuar Matricës së Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve 2021-2025, synohet që 270 biznese të drejtuar nga romët dhe egjiptianët të përfitojnë nga ulja 50% e taksave vendore.

Për të bërë të mundur realizimin e objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje te romëve dhe egjiptianëve 2021-2025, kompetencë e Drejtoria e Përgjithshme së Shërbimit Social sugjeron të bëhen disa ndryshime për bizneset e ngritura nga Romët dhe Egjiptianët si dhe për ambulancët që tregtojnë produkte artizanale, mallra edhe shërbime të tjera si më poshtë:

- uljen e taksës së ndërtesës me 30%, për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët
- uljen me 50% nga tarifa e pastrimit dhe nga tarifa e zënies së hapësirës publike për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët, si dhe për ambulancët

Për identifikimin e identitetit të një individi me përkatësi Rom ose Egjiptian ka 3 elementë:

- 1) Deklarimi nga vetë individi për identitetin e tij
- 2) Njohja nga të tjerët për identitetin e tij dhe
- 3) lidhja e individit me elementët historik dhe kulturor të pakicës Rome ose Egjiptiane.

Për ato subjekte që kanë të punësuar një numër të konsiderueshëm punonjësish Rom ose Egjiptian, DPSHS sugjeron të ulen taksat në masen 50% për ato biznese, të cilat numri i të punësuarve Rom dhe Egjiptian zënë mbi 30% të numrit total të të punësuarve në atë biznes.

Duke ju referuar te dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, e cila në bashkëpunim me partnerë të Shoqërisë Civile ka ndërtuar dy tregje për tregtarët e pakicës rome dhe egjiptiane që tregtojnë rroba të përdorura në Selitë dhe Shkozë. Të dy këto tregje kanë mundur vetëpunësimin e 207 individëve nga këto pakica.

Ndërkohe mendohet se tregtarë të mundshëm mund të jenë:

- afërsisht 100 tregtar Rom dhe Egjiptian që shesin si ambulat në mënyrë informale;
- afërsisht 500 tregtar Rom dhe Egjiptian që shesin në tregje dhe dyqane;
- afërsisht 50 biznese që kanë të punësuar më shumë se 30 % Rom dhe Egjiptian në bizneset e tyre.

Për sa i përket efektit financiar duke qenë se nuk është e përcaktuar saktësisht numri I bizneseve dhe lloji i sipërfaqes për përcaktimin e taksës së ndërtesës dhe lloji i aktivitetit për tarifën e pastrimit nuk arrijmë dot të përcaktojmë efektin financiar për këto dy taksa dhe tarifa.

Në lidhje me tarifën e zënies së hapësirës publike duke marrë numrin 500 dhe hapësirën publike maksimumi 10 m2 dhe duke marrë zonën B për referencë efekti financiar i lehtësimit për një vit financiar është mesatarisht 22,500,000 lekë.

3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Bazuar në vendimin nr.457, datë 26.07.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ‘ndërtesa’, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” të ndryshuar, vendim i cili ka bërë ndryshimin e Aneksit nr.2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.132, datë 07.03.2018;

ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrikat, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshirë ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zones përkatëse, sipas njësive administrative të Bashkisë Tiranë. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura”.

Nisur nga ky ndryshim nga ana e Drejtorise së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit është kërkuar një fjali sqaruese brenda pikës 2 duke shtuar togfjalëshin “*dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli*” dhe duke e ndryshuar pikën 2 si më poshtë:

2. Niveli i taksës në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t’u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit ***dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli***. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas

përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.

Referuar ligjit nr. 67/2023, Për një ndryshim dhe disa shtesa në ligjin Nr. 9632, Datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, në nenin e parashikuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është ndarë në një pikë të veçantë pjesa për strukturat e që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive. Si pasojë e këtyre ndryshimeve lind i nevojshëm reflektimi i ndryshimeve në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 158 datë 26.12.2019.

Konkretisht propozojmë këto ndryshime në VKB nr. 158 datë 26.12.2019, në nenin 23:

- Në pikën 3 “a” fjala “të bujqësisë” hiqet
- Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me përmbajtje si më poshtë:

a/1. Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 2 (dy) përqind e vlerës së investimit”.

- Shtohet paragrafi “e” me përmbajtje si më poshtë:

e. “Për subjektet që janë në process aplikimi për t’u pajisur me leje ndërtimi për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 2 (dy) përqind e e vlerës së investimit”.

Bashkia Tiranë ka propozuar të jetë në normën 2% duke marrë parasysh kapacitetin pagues të këtyre subjekteve dhe peshën që mbajnë këto sektorë të ekonomisë në Bashkinë Tiranë.

4. Tarifa e Pastrimit

Subjektet e biznesit që kanë si aktivitet kryesor ndërtimin kanë paraqitur me anë të shkresave të ndryshme një shqetësim për tarifimin e padrejtë të kantierëve të ndërtimit.

Për tu miratuar një leje ndërtimi për ndërtimin e një objekti qoftë një shtëpi individuale qoftë një ndërtesë rezidenciale ose bllok banimesh aplikimi duhet të kryhet nga një shoqëri e autorizuar me të drejtë nënshkrimi.

Tarifimi në lidhje me pastrimin për çdo kantier ndërtimi bëhet në bazë të kategorizimit të madhësisë së subjektit që ka aplikuar për lejen e ndërtimit, pa marrë parasysh volumin e objektit që ndërtohet apo destinacionin.

Pra shoqëritë ndërtuese paguajnë të njëjtën tarifë si në ndërtimin e një objekti banimi individual ose objekt shërbimi, edhe në ndërtimin e një objekti shumëkatësh më destinacion rezidencial ose njësi ekonomike, dhe kjo sjell pabarazi në trajtimin për tarifimin e tyre.

Për të bërë të mundur ngarkimin në mënyrë të drejtë të taksapaguesve sipas kosos së pastrimit dhe duke ndihmuar procesin e aplikimit për leje ndërtimi për shtëpitë individuale duke u bazuar

në dy grupime kryesore mbi të cilat llogaritet dhe paguhet taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, mbi të cilat propozojmë si më poshtë:

Në VKB nr. 158/2019, në aneksin nr.6. “Tarifa e Pastrimit”, seksioni II.4 “Subjekte Ndërtimi”, të ndryshohet vlera e tarifës për kategoritë Biznes i vogël me xhiro 2-8 milionë, Biznes i Madh dhe Biznes Vip, për pikën “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to”.

Konkretisht me ndarje si më poshtë:

a) Njësi ndërtimi me destinacion banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi: të ngelet e njëjtë

b) Njësi ndërtimi që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike:

ndryshohet vlera e tarifës për kategoritë: Biznes I vogël me xhiro “2-8 milionë” nga 34,500 në 17,250 lekë, Biznes i Madh nga 345,000 në 172,500 lekë dhe për kategorinë Biznes Vip nga 517,500 në vlerën 258,750 lekë.

SUBJEKTE NDËRTIMI	0-2	2-8	BM	VIP
Njësi ndërtimi me destinacion banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi	5,750	34,500	345,000	517,500
Njësi ndërtimi që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike	5,750	17,250	172,500	258,750
Rikonstruksione të pjesshme	5,750	17,250	172,500	257,600
Punime në fushën e ndërtimit	5,750	17,250	172,500	257,600
Subjekte ndërtuese për selinë administrative	5,750	17,250	41,400	69,000
Subjektet e Karrierave për prodhim guri, inerte etj të ngjashme me to,	5,750	17,250	115,000	115,000

Për të njëjtën tarifë propozojmë edhe amendimin e nenit 42 pikës 6 me heqjen e kategorisë “Rikonstruksione të pjesshme” pasi rikonstruksionet nuk aplikojnë për t’u pajisur me çertifikatë përdorimi, dhe kjo bie ndesh me çfarë parashikon neni aktual në frazën “deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për leje shfrytëzimi pranë Bashkisë Tiranë”.

Nenin 42, pika 6, nga “Për kategorinë II. “Subjekte Ndërtimi” nënkategorinë “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to” “Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla kopshte, objekte banimi e tregtare, etj të ngjashëm me to”, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në momentin e paraqitjes se

kërkesës për leje shfrytëzimi pranë Bashkisë së Tiranës. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit”

Të ndryshohet në;

“Për kategorinë II. “Subjekte Ndërtimi” nënkategorinë:

6.i “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to”, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për leje shfrytëzimi pranë Bashkisë së Tiranës. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit. Për çdo rast tjetër “Rikonstruksioni të pjesshëm”, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me proces verbalin e dorëzimit të punimeve dhe proces verbalin nga sektori i verifikimit në terren.”

Disa raste të ndryshme të kantierëve të ndërtimit që hasin vështirësi në mënyrën se si do të tarifohen:

- Afati i taksimit/përlllogaritjes së detyrimit për leje ndërtimi të miratuara por që nuk janë vënë në shfrytëzim!

Shembull: Rasti kur miratohet leje ndërtimi, kryesisht për banesa individuale, por nuk vihet në shfrytëzim/zbatim nga zhvilluesi/ndërtuesi deri në përfundim të afatit të lejes. Propozojmë minimalisht përlllogaritjen e detyrimit vetëm përgjatë afatit të vlefshmërisë së lejes së ndërtimit, ndërprerjen e detyrimit me përfundimin e afatit të lejes pavarësisht mungesës së aplikimit për certifikatë përdorimi, kjo pasi subjektet nuk mund të aplikojnë për certifikatë përdorimi për një objekt i cili nuk është ndërtuar asnjëherë (aplikimi në fjalë do të ishte “nul”).

Për të tilla raste, propozojmë që Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të ketë të drejtën e stopimit të detyrimit nëpërmjet kontaktimit me proces verbal nga sektori i verifikimit në terren ku të konfirmohet se në objekt nuk është kryer asnjë punim. Pra, pas paragrafit “Për kategorinë II. “Subjekte Ndërtimi” nënkategorinë “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to, rikonstruksione me ndryshim funksioni”, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për leje shfrytëzimi pranë Bashkisë së Tiranës. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit. Çdo rast tjetër “Rikonstruksioni të pjesshëm”, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me proces verbalin e dorëzimit të punimeve dhe proces verbalin nga sektori i verifikimit në terren.

Për të bërë tarifimin e saktë të kësaj nëndarjeje të shtohet edhe pika 6.ii:

6.i.i “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to, rikonstruksione të pjesshme të ngjashme me to, për të cilat miratohet leje ndërtimi por nuk vihet në shfrytëzim/zbatim nga zhvilluesi/ndërtuesi deri në përfundim të afatit të lejes, llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë

me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me proces verbalin nga sektori i verifikimit në terren.”

- **“Leje ndërtimi për prishje objekti”**

Referuar informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, janë vënë re dy mënyra të trajtimit të prishjes së objekteve para fillimit të ndërtimit të ri:

- o Rasti i parë dhe i hasur më gjerësisht është miratimi i lejeve të ndërtimit për objekte të reja, kryesisht godina të kombinuara banim + shërbim, dhe në njërën prej pikave në vendimin për miratimin e lejes së ndërtimit cilësohet se “...prishja e objekteve ekzistuese do bëhet para fillimit të ndërtimit të objektit të ri”.

- o Rasti i dytë dhe i hasur disi më rrallë është miratimi i “Lejeve të ndërtimit për prishje objekti” kryesisht me afat 3-6 mujor, me përfundimin e të cilave miratohet “Leja e ndërtimit për objekt banimi + shërbimi...”.

Të tilla raste propozojmë t’i tarifojmë në nënkategorinë “Punime në fushën e ndërtimit” ku tarifa e pastrimit të jetë e njëjtë me “Rikonstruksione të pjesshme. Gjithashtu, si periudhë e tarifimit të jetë afati i vlefshmërisë së lejes në fjalë ose periudha nga zbardhja e lejes deri në momentin e konfirmimit të përfundimit të punimeve me proces verbal nga sektori i verifikimit në terren, kjo pasi subjektet nuk mund të aplikojnë për çertifikatë përdorimi për “Leje ndërtimi për prishje objekti”.

- **“Leje ndërtimi muri rrethues”**

Shembull: Rasti kur miratohet leje për ndërtim muri rrethues, nga DPTTV kategorizohen aktualisht si “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi”, kategori e cila sipas VKB nr. 158, datë 26.12.2019 duhet të pajiset me aplikim për çertifikatë përdorimi në mënyrë që të vijohet me mbylljen kantierit. Propozojmë që të tilla leje të kategorizohen si “Punime në fushën e ndërtimit” ku tarifa e pastrimit të jetë e njëjtë me “Rikonstruksione të pjesshme. Gjithashtu, si periudhë e tarifimit të jetë afati i vlefshmërisë së lejes në fjalë ose periudha nga zbardhja e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me proces verbalin e dorëzimit të punimeve dhe proces verbalin nga sektori i verifikimit në terren.

- Të shtohet gjithashtu edhe pika 6.iii:

6.iii “Punime në fushën e ndërtimit” me pikat e mëposhtme:

- a- “Lejet e ndërtimit për prishje objekti” kryesisht me afat 3-6 mujor, me përfundimin e të cilave miratohet “Leja e ndërtimit për objekt banimi + shërbim” me periudhë tarifimi afatin e vlefshmërisë së lejes në fjalë ose periudha nga zbardhja e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të punimeve, shoqëruar me proces verbalin nga sektori i verifikimit në terren.”

- b- “Lejeve për ndërtim muri rrethues” me periudhë tarifimi afatin e vlefshmërisë së lejes në fjalë ose periudha nga zbardhja e lejes së ndërtimit deri në përfundimin e afatit të

punimeve, shoqëruar me proces verbalin e dorëzimit të punimeve dhe proces verbalin nga sektori i verifikimit në terren.”

5. Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime

Duke iu referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e Manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim mbi krijimin e një sistemi të integruar të informatizimit të manualit të çmimeve i cili unifikon metodologjinë e llogaritjes të paraqitjes së preventivave dhe situacioneve, lind nevoja për ndryshim të pikës 3.

3. Për leje ndërtimi tarifa është në vlerën 1 për qind e vlerës së investimit. Vlera e investimit llogaritet sipas koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave ose preventivin e investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave.

Duke qenë se preventivi do të hartohet në sistemin e integruar të informatizimit të manualit të çmimeve, pjesa e fjalisë që lidhet me koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave dhe krahasimi i vlerave nuk ka më vlerë. Për këtë arsye propozojmë ndryshimin e fjalisë së dytë të pikës 3 si më poshtë:

“Vlera e investimit llogaritet sipas preventivit të investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar të hartuar sipas sistemit të integruar të informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

6. Tarifa për Kopshtet dhe Çerdhet

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, në përmbushje të misionit të saj për mirërritjen, zhvillimin dhe edukimin të fëmijëve frekuentues të çerdheve dhe kopshteve publike të Bashkisë, si dhe duke u bazuar në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, në mënyrë të përvitshme, ka konstatuar, gjatë procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Ushqime”, se çmimet e ushqimeve kanë ardhur duke u rritur, konkretisht në periudhën 2021-2022-2023 kanë pësuar një rritje të ndjeshme (referuar INSTAT).

Aktualisht tarifa e miratuar, 130 lekë në ditë në çerdhe dhe 160 lekë në ditë në kopshte, nuk përballon blerjen e artikujve ushqimorë. Ky fakt u vërtetua gjatë procedurës për blerjen e ushqimeve për periudhën 2023-2024, kur institucionit ju desh të planifikonte blerjen e artikujve ushqimorë për periudhën 12 mujore sipas studimit të tregut, duke tejkalluar tarifën ditore të detyrimit ushqimor.

Përsa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, duke marrë në konsideratë përmbushjen e misionit të saj për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve si dhe furnizimin me ushqim në mënyrë të përditëshme të vazhdueshme e të pandërprerë, ka kryer llogaritje të vazhdueshme dhe periodike për tarifën e detyrimit ushqimor në çerdhet dhe kopshtet.

Konkretisht, referuar menusë së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Urdhërit nr.457 datë 13.06.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, normativave respektive ushqimore, si dhe numrit të fëmijëve, janë parashikuar sasitë ushqimore të nevojshme për secilin artikull për 12 muaj kalendarikë.

Duke patur parasysh sasitë e nevojshme, sipas llogaritjeve të sqaruara më lart dhe çmimet e fondit limit të periudhës 2023-2024 (studimit të tregut), parashikohet kosto si më poshtë:

Nr	Artikulli	Njesia	Cmim. FL 2023	Cerdhe		Kopshte		Totali	
				Sasia	Vlera	Sasia	Vlera	Sasia	Vlera
	Loti II: "Blerje bulmet , qumësht, kos, djath, gjizë"								
1	Qumesht tetrapak	Litra	158.33	115350	18263340	357464	56597271	472814	74860611
2	Kos	Kg	157.00	89032	13978099	158170	24832674	247202	38810773
3	Djath i bardhe	Kg	683.33	4557	3113674	3163	2161645	7720	5275319
4	Djath kaçkavall	Kg	1013.33	826	836983	0	0	826	836983
5	Gjize pa kripe	Kg	242.00	2478	599657	28471	6889881	30949	7489537
	Loti III: "Blerje bukë thekre dhe integrale"								
6	Buke thekre	Kg	144.33	18133	2617168	59472	8583577	77605	11200745
7	Buke integrale	Kg	160.00	27201	4352086	89208	14273252	116408	18625338
	Loti I: "Blerje mish vici, mish pule, vezë "								
8	Veze	Kokrra	21.50	457917	9845211	755758	16248788	1213674	26093999
9	Mish pule	Kg	408.33	10610	4332333	22043	9000790	32653	13333123
10	Mish vici	Kg	970.00	20572	19955116	31490	30545203	52062	50500319
	Loti IV: "Blerje artikuj ushqimor"								
11	Vaj ulliri i virgjër	Litra	901.67	11169	10071081	22200	20017416	33370	30088497
12	Fasule	Kg	271.67	3532	959638	12596	3421944	16128	4381582
13	Makarona te gjata	Kg	215.00	0	0	15745	3385164	15745	3385164
14	Makarona te vogla	Kg	208.33	8153	1698477	0	0	8153	1698477
15	Recel qershie	Kg	351.67	2446	860131	4723	1661108	7169	2521239
16	Recel kumbllë	Kg	361.67	2446	884589	3149	1138895	5595	2023484
17	Trahana	Kg	266.67	3696	985598	6298	1679482	9994	2665080
18	Sheqer	Kg	106.67	2600	277325	5668	604625	8268	881950
19	Oriz	Kg	170.67	6813	1162770	17319	2955910	24132	4118679
20	Miell gruri	Kg	108.67	5272	572925	11021	1197703	16294	1770628
21	Miell misri	Kg	123.33	0	0	9447	1165095	9447	1165095
22	Miell orizi	Kg	276.67	54	15038	0	0	54	15038
23	Thjerreza	Kg	268.33	3714	996594	12596	3379874	16310	4376468
24	Tershere	Kg	296.67	11436	3392645	18894	5605265	30330	8997910
25	Drithera per femije	Kg	2093.33	136	284442	0	0	136	284442
26	Kripe	Kg	30.33	1631	49455	3047	92425	4678	141880

27	Qiqra	Kg	466.67	67	31373	0	0	67	31373
28	Vanilje	Kg	1008.33	188	189990	315	317522	503	507512
29	Pluhur pjekje	Kg	1153.33	188	217311	315	363182	503	580494
30	Kanelle	Kg	1713.33	65	111748	126	215810	191	327558
31	Arra moskati	Kg	5885.00	0	0	31	185318	31	185318
32	Rigon i tharë	Kg	1630.00	65	106313	189	307971	254	414284
Loti V: "Blerje Fruta dhe zarzavate"									
33	Bizele	Kg	308.33	6695	2064119	19029	5867282	25724	7931401
34	Domate	Kg	109.67	15419	1690973	24557	2693187	39976	4384160
35	Karrota	Kg	95.67	38283	3662545	67799	6486316	106082	10148861
36	Spinaq	Kg	157.67	6670	1051593	8182	1289980	14851	2341574
37	Pataate	Kg	66.67	56968	3798055	69893	4659769	126861	8457824
38	Limon	Kg	175.00	1891	330948	3659	640312	5550	971259
39	Majdanoz i fresket	Kg	366.67	208	76138	477	175056	685	251194
40	Qepe	Kg	69.33	3556	246562	7944	550749	11500	797311
41	Hudher e thare	Kg	298.33	69	20446	159	47376	227	67822
42	Kungull	Kg	83.67	9644	806886	8932	747351	18576	1554237
43	Selino i fresket	Kg	326.67	277	90389	479	156371	755	246759
44	Kastravec	Kg	94.33	2616	246808	6692	631234	9308	878042
45	Brokoli	Kg	156.67	3743	586343	2249	352420	5992	938763
46	Lulelaker	Kg	155.00	3515	544778	2242	347440	5756	892218
47	Presh	Kg	90.00	663	59634	31490	2834091	32153	2893725
48	Borzilok	Kg	1371.67	19	25421	0	0	19	25421
49	Kungull i verdhe	Kg	63.33	866	54831	0	0	866	54831
50	Banane	Kg	193.33	63424	12261675	52836	10214693	116259	22476368
51	Portokall	Kg	96.67	46601	4504891	61715	5966018	108316	10470909
52	Mandarina	Kg	104.00	10910	1134619	22150	2303621	33060	3438240
53	Dardha	Kg	147.00	12813	1883493	18889	2776733	31702	4660226
54	Pjeper	Kg	80.00	6390	511205	8518	681435	14908	1192640
55	Kivi	Kg	189.00	2458	464581	4848	916253	7306	1380834
56	Molle	Kg	99.67	45711	4556010	75522	7527327	121233	12083337
57	Pjeshka	Kg	114.00	10203	1163143	13555	1545269	23758	2708412
Vlera totale					142,597,195		276,238,074		418,835,269

Në vijim, duke kryer llogaritjet e tarifës së detyrimit ushqimor, duke ju referuar çmimeve dhe sasive të mësipërme, rezulton si më poshtë:

	Muaji	Cerdhet						Kopshtet						Vlera Totale
		Plani-fikimi fillestar 2023	Parashikim shtese 10%	Frekue-ntimi i para-shikuar 2024	Ditet e muajit	Kuota ditore	Vlera	Plani-fikimi fillestar 2023	Parashikim shtese 10%	Frekue-ntimi i para-shikuar 2024	Ditet e muajit	Kuota ditore	Vlera	
2024 - 2025	Janar	3196	320	3516	22	149	11,524,137	5,919	592	6511	22	166	23,777,807	35,301,944
	Shkurt	3196	320	3516	22	149	11,524,137	5,709	571	6280	22	166	22,934,195	34,458,332
	Mars	3416	342	3758	22	149	12,317,413	6,024	602	6626	22	166	24,199,613	36,517,026

Prill	3746	375	4121	22	149	13,507,327	6,339	634	6973	22	166	25,465,031	38,972,358
Maj	3746	375	4121	22	149	13,507,327	6,549	655	7204	22	166	26,308,643	39,815,970
Qershor	3306	331	3637	22	149	11,920,775	4,344	434	4778	22	166	17,450,717	29,371,492
Korrik	2866	287	3153	22	149	10,334,223	4,029	403	4432	22	166	16,185,299	26,519,522
Gusht	2316	232	2548	22	149	8,351,033	2,979	298	3277	22	166	11,967,239	20,318,272
Shtator	3086	309	3395	22	149	11,127,499	5,709	571	6280	22	166	22,934,195	34,061,694
Tetor	3526	353	3879	22	149	12,714,051	7,074	707	7781	22	166	28,417,673	41,131,724
Nentor	3526	353	3879	22	149	12,714,051	7,074	707	7781	22	166	28,417,673	41,131,724
Dhjetor	3526	353	3879	22	149	12,714,051	7,074	707	7781	22	166	28,417,673	41,131,724
Vlera në lek (me TVSH)						142,256,022						276,475,756	418,731,777

Në përfundim çmujmë të arsyeshme se rishikimi i tarifës ditore të detyrimit për ushqim që paguhet nga prindrit/kujdestarët ligjor të fëmijëve frekuentues të çerdheve dhe kopshteve publike të BT sipas frekuentimit ditor, me qëllim përbalimin e çmimeve aktuale, duhet të jetë 150 lekë në ditë në çerdhe dhe 170 lekë në ditë në kopsht.

Ritheksojmë se tarifa e mbetur e pandryshuar që nga viti 2015, nuk reflekton ndryshimin e çmimeve të artikujve ushqimor nga viti 2015 e në vazhdim. Aktualisht tarifa e miratuar nuk përballon blerjen e artikujve ushqimorë.

Tarifat e propozuara nga ana jonë, **konkretisht 150 lekë në ditë në çerdhe dhe 170 lekë në ditë në kopshte**, reflektojnë ndryshimet e çmimeve që nga viti 2015, si dhe rritjen e çmimeve të artikujve ushqimorë sipas studimeve periodike të INSTAT.

7. Tarifa për Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit

Bazuar në vendimin nr. 135 datë 22.12.2023 të krijimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik dhe ndarjen e Kopshtit zoologjik dhe kalimin nën një strukturë të re me heqjen e pikës 1 parashikojmë dhe ndryshimin e pikave të Nenit: Tarifa për Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit.

Në nenin e tarifave është bërë gjithashtu shtesa për sqarim për pozicionimin e trenit panoramik.

- Rishikimi i tarifës së fushave të tenisit "Perlat Voshina"

Pas konsultimeve me grupet e interesit dhe sportistë që merren me sportin e tenisit, dhe analizës së kostove, nga ana e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit është propozuar një tarifë e vetme për individë për 60 minuta lojë në shumën 1,000 lekë, pa bërë ndarjen për individë dhe subjekte private ose shoqata.

Ky propozim ka ardhur pas një studimi të tregut të kryer nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit fushave të tenisit në Bashkinë Tiranë dhe kërkesave shumë të ulëta për përdorimin e fushave me tarifë që janë në fuqi.

Tregues është edhe niveli i arketimeve nga këto fusha për vitin 2022 deri në muajin gusht 2023 janë në nivelin 104,000 lekë, që tregojnë që frekuentimi është i ulët.

Nëse u referohemi tarifave të fushave të tenisit që operojnë në qytetin e Tiranës sipas informacionit të marrë, ato janë si më poshtë:

Fusha e tenisit pranë Hotel “Rogner” - 1,500 lekë/60 min

Fusha e tenisit pranë Shallvareve - 1,000 lekë/60 min

Fushat e tenisit në zonën e Alliasit - 1,000 lekë/60 min

Duke analizuar tabelën e kostove kemi hapësirë për ndryshimin e vlerës duke marrë parasysh se në kostimin e zërave të përfshirë është llogaritur kostoja e rojeve të sigurisë me tre turne, shërbim i cili nuk është prokuruar për këto fusha dhe nuk ka roje të dedikuara për këtë zonë. Ruajtja e fushave bëhet nga kontratat ekzistuese të rojeve private që janë parashikuar si kosto për fushat e tjera, pjesë e PMLAT.

Në VKB 158/2019 pika 7 propozojmë të hiqet se nuk ka lidhje logjike me tarifat që i referohet.

7. Tarifat e sipërpërmendura do të aplikohen vetëm në rastet e përdorimit nga ekipet sportive; akademitë sportive për fëmijë, të rinj dhe të rritur si dhe shoqata të ndryshme sportive.

Kjo pikë ka ngelur gjatë përgatitjes së VKB 158/2019 duke u ndryshuar gabimisht në “të sipërpërmendura” ndërkohë që në VKB paraardhëse 59/2015 ka qenë e referuar “të poshtë përmendura”. Pika nuk bën sens edhe për tarifat e mëposhtme sepse tarifat janë të ndara sipas individëve ose persona fizikë/juridikë.

8. Tarifat për hyrjen në Kopshtin Zoologjik

Me hapjen dhe funksionimi e kopshtit zoologjik në përditshmëri është vënë re se zbatimi i tarifës së pjesshme e cila është përcaktuar për hyrjen e vizitorëve në zonën e dinosaurëve, është i pamundur për shkak se zona e dinosaurëve nuk ka një hyrje të posaçme, që mund të kryejë ndarjen e vizitorëve ndërmjet zonës së kafshëve të egra dhe zonës së dinosaurëve.

Hyrja e vizitorëve është e përbashkët dhe si rrjedhojë vizitorët, të cilët dëshirojnë të futen në zonën e dinosaurëve me tarifë të pjesshme nuk kanë asnjë kufizim fizik për të vizituar edhe pjesën tjetër të kopshtit zoologjik, ku ndodhen kafshët e egra.

Kësisoj, tarifa e pjesshme e parashikuar për t’u përdorur për vizitorët e të gjitha kategorive, të cilët dëshirojnë të hyjnë vetëm në zonën e dinosaurëve duhet të hiqet, pasi sipas shpjegimit në sa më sipër, me mungesën e një ndarje fizike të dy zonave, përkatësisht zonës së kafshëve dhe zonës së dinosaurëve.

Sa i takon tarifës së hyrjes për fëmijët deri në moshën 18 vjeç, vlerësojmë se kjo tarifë duhet të rishikohet duke mbajtur parasysh se pjesa më e madhe e tyre janë fëmijë të vegjël, të cilët shoqërohen nga prindërit ose kujdestarët ligjor. Ndryshimi i tarifës duke u ulur vlerën e biletës aktuale me 50 (pesëdhjetë) lekë për këtë grupmoshë, do të krijoj mundësinë për prindërit dhe

kujdestarët që të shtojnë numrin e vizitave që kryejnë në Kopshtin Zoologjik, duke mbajtur në këtë mënyrë nivelin aktual të të ardhurave që krijohen nga shitja e biletave për këtë kategori vizitorësh.

Ndërkohë po bëhet një specifikim për grupe mbi 10 persona tarifa për hyrje në kopshtin zoologjik të jetë 100 lekë për person, pjesë e grupit, pasi në vendimin e Këshillit Bashkiak, është përcaktuar për grupe mbi 10 persona (fëmijë deri në 14 vjeç), tarifa është 100 lekë,

Gjithashtu sqarojmë se edhe tarifa e parashikuar për grupe deri në 5 (pesë) persona nuk është e zbatueshme, pasi krijon keqkuptime në lidhje me numrin minimal, që duhet të konsiderohet “grup personash”.

Konkretisht vlerësojmë se numri minimal që duhet të përbëjë grupin duhet të jetë 10 persona dhe tarifa që duhet të aplikohet duhet të jetë 100 lekë për person.

Vlen të konsiderohet edhe mundësia për të rishikuar tarifën e hyrjes në Kopshtin Zoologjik për një kategori shumë të ndjeshme si ajo e personave me aftësi të kufizuara. Ashtu si shumë shërbime dhe tarifa të tjera vendore për të cilat kjo kategori ka përjashtime, do duhet që edhe hyrja në Kopshtin Zoologjik të jetë e përjashtuar nga tarifa për këtë kategori qytetarësh.

Me krijimin e Drejtorisë së përgjithshme të Kopshtit Zoologjik tarifat për biletat e hyrjes në kopshtin zoologjik kalojnë nën administrimin e kësaj drejtorie dhe kemi parashikuar krijimin e neneve të veçantë për këtë drejtori.

9. Tarifat për funksionimin e “Kinema Agimi”

Agjencia e Industrisë Kreative Tiranë e krijuar me Vendimin nr.5, datë 10.02.2022 të Këshillit Bashkiak “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Industrisë Kreative Tiranë”, ka si qëllim kryesor zhvillimin e industrisë, sipërmarrjes dhe ekonomisë krijuese në fushën e artit të filmit, të rekreacionit dhe të teknologjisë duke ofruar aktivitete, shërbime, trajnime dhe hapësira të dedikuara, për individë dhe sipërmarrje aktive në Tiranë.

Ndër detyrat dhe funksionet e Agjencisë së Industrisë Kreative Tiranë është ri-vitalizimi i kinemave të qytetit, shfaqja e filmave shqiptarë dhe të huaj në sallat e kinemave, menaxhimi, mirëmbajtja dhe qeradhënia e ambienteve dhe sallave, etj., të parashikuara këto në pikën 3 të Vendimin nr.5, datë 10.02.2022 të Këshillit Bashkiak.

Për realizimin e detyrave dhe funksioneve të sipërcituara dhe të tjera, me Vendimin nr.71, datë12.07.2022 të Këshillit Bashkiak, Agjencisë së Industrisë Kreative Tiranë i kaloi në administrim objekti “Kinema Agimi”, me nr.pasurie 2/106-N20, ZK 8270, në pronësi të Bashkisë Tiranë.

Agjencia e Industrisë Kreative ka kërkuar ndryshimin e Vendimit nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar, për shtimin e një kreu të veçantë, ku të parashikohen Tarifat për kinemanë “Agimi” Tiranë, të përcaktuara në katër nene, të cilat vendosin tarifat për biletat e kinemasë, tarifat për

dhënien në përdorim të dy sallave të kinemasë, përjashtimet përkatëse dhe strukturën e ngarkuar për mbledhjen e tarifave.

Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre.

Sa më sipër, propozimi reflektohet në shtesën e strukturuar si më poshtë vijon:

Në nenin e parë të Kreut “Tarifat për kinemanë “Agimi” parashikohen tarifat për biletat e kinemasë “Agimi”, të cilat do të jenë si më poshtë:

- g) Biletë Individuale (Paradite, 09:00-12:00) 400 lekë;
- h) Biletë Individuale (Mesditë-Pasdite, 12:00-20:00) 500 lekë;
- i) Biletë Individuale (Darkë, 20:00-00:00) 400 lekë;
- j) Biletë për fëmijët e Arsimit 9-vjeçar 100 lekë;
- k) Biletë për studentët (të pajisur me kartën e studentit të vlefshme) në masën 50% të biletave sipas orarit përkatës;
- l) Biletë për personat e moshuar 200 lekë;

Propozimi i këtyre tarifave për biletat e kinemasë “Agimi” është munduar të ofrojë tarifat më të ulëta krahasuar me tregun aktual të biletave të kinemasë, duke tërhequr në këtë mënyrë komunitetin drejt një jete më sociale, pranë kinematografisë, shfaqjeve teatrale etj.

Në nenin e dytë parashikohen tarifat për dhënien në përdorim të sallave në kinemanë “Agimi”, për aktivitete të ndryshme, të llogaritura në orë, ditë apo javë, në varësi të aktivitetit dhe programit përkatës që mbulon aktivitetin, si më poshtë:

- g) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e madhe (Evente të klientëve, evente kompanie, prezantime produkti, konferencë, leksione, seminare, kurse) 5,000 lekë/orë;
- h) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e vogël (Evente të klientëve, evente kompanie, prezantime produkti, konferencë, leksione, seminare, kurse) 1,000 lekë/orë;
- i) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e madhe (Ekspozitë, shfaqje private, filma premiere, evente festive, aktivitete komunitare) 20,000 lekë/ditë;
- j) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e vogël (Ekspozitë, shfaqje private, filma premiere, evente festive, aktivitete komunitare) 10,000 lekë/ditë;
- k) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e madhe (Muze) 100,000 lekë/javë;
- l) Tarifa për dhënien në përdorim/Sallë e vogël (Muze) 40,000 lekë/javë;

Propozimi i këtyre tarifave për dhënien në përdorim të sallave në kinemanë “Agimi” është strukturuar në bazë të një analizë kostoje të Agjencisë së Industrisë Kreative Tiranë për objektin “Kinema “Agimi”, e cila është reflektuar në zërat dhe shifrat në (Tabela nr.1, bashkëlidhur këtij Relacioni) dhe një parashikimi të të ardhurave që mund ti vijjnë AIK-së nga përdorimi i sallave të kinemasë dhe shitja e biletave (Tabela nr.2, bashkëlidhur këtij Relacioni).

Në nenin e tretë parashikohen përjashtimet për të dyja rastet si më poshtë:

Përjashtohen nga pagesa e tarifës për biletat e kinemasë “Agimi”, kategoritë e mëposhtme:

- Të sëmurë tetraplegjikë dhe paraplegjikë;
- Personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit 93/2014;
- Delegacione zyrtare shtetërore;

Në mënyrë që të funksionojë parashikimi më sipër, duhet që përjashtimet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, personat, në momentin e hyrjes në kinema, të paraqesin dokumentin përkatës që vërteton statusin e tyre.

Gjithashtu është parashikuar në pikën 2 të këtij neni se nuk aplikohen tarifa për marrjen në përdorim të sallave të kinemasë “Agimi”, për aktivitetet me interes publik për qëllime sociale, aktivitetet nga subjekte me mision bamirësie, nisma të Bashkisë Tiranë, ente arsimore publike dhe aktivitete të shtëpisë së fëmijës “Zyber Hallulli”

Në nenin e katërt është parashikuar struktura e cila duhet të ngarkohet për mbledhjen e tarifave të parashikuara në nenin 1 dhe 2 të këtij Kreu, e cila si rrjedhojë do të jetë Agjencia e Industrisë Kreative Tiranë dhe sipas akt-rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, do të kalojë të ardhurat 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.

TABELA NR.1 ANALIZA E KOSTOS (Në lekë)

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmim	Kosto/ Mujore
I	Shp. Personeli				
1	Punetor biletar	punonjes	2	45,000	90,000
2	Punetor sanitar	punonjes	2	42,000	84,000
3	Personel Administrative	punonjes	1	68,000	68,000
4	Pergjegjes Sektori	punonjes	1	85,000	85,000
1	Fondi I vecante 5%				16,350
2	Sigurimet shoqerore 16.7%				54,609
	Shuma I				397,959
II	Baza materiale				-
1	Mirembajtje pajisjesh	sherbim	1	10,000	10,000
2	Sistem kondicionimi	sherbim	1	12,000	12,000
3	Detergjente	set	1	10,000	10,000
	Shuma II				32,000

III	Shpenzime te tjera				-
1	Energji elektrike	kë	20,000	16	320,000
2	Uje	m3	97	206	20,041
	Shuma III				340,041
	TOTALI I +II + III				770,000

TABELA NR.2 TË ARDHURAT E PARASHIKUARA (Në lekë)

Nr	Të ardhura nga funksionimi	Njësia	Sasia	Cmimi	Të ardhura/ Mujore
1	Tarifë përdorimi/Sallë e madhe me orë	ore	20.00	5,000	100,000
2	Tarifë përdorimi/Sallë e vogël me orë	ore	20.00	1,000	20,000
3	Tarifë përdorimi/Sallë e madhe me ditë	dite	5.00	20,000	100,000
4	Tarifë përdorimi/Sallë e vogël me ditë	dite	6.00	10,000	60,000
5	Tarifë përdorimi/Sallë e madhe me javë	jave	0.50	100,000	50,000
6	Tarifë përdorimi/Sallë e vogël me javë	jave	1.00	40,000	40,000
7	Të ardhura nga shitja e biletave të kinemasë	muaj	1.00	400,000	400,000
	TOTALI				770,000

Këto tarifa janë vendosur pas një studimi të tregut dhe tarifave që janë të vendosura nga kinematë ekzistuese në qytetin e Tiranës. Krahasimi i çmimeve të biletave të kinemasë sipas specifikimeve dhe grupeve të frekuentimit pasqyrohet më poshtë:

Krahasim me Tarifat e Kinemave Millenium dhe Cineplexx				
Të ardhura nga funksionimi	Biletat e Propozuara	Cmimi Min	Cmimi Max	Komente

Biletë Individuale (Paradite, 09:00-12:00)	400	470	800	Ndryshojnë sipas ditës së javës
Biletë Individuale (Mesditë-Pasdite, 12:00-20:00)	500	470	800	Ndryshojnë sipas ditës së javës
Biletë Individuale (Darkë, 20:00-00:00)	400	470	800	Ndryshojnë sipas ditës së javës
Biletë për fëmijët e Arsimit 9-vjeçar	100	400	550	Fëmijë të antarësuar në Klubin Familjar të Filmit
Biletë për studentët (të pajisur me kartën e studentit të vlefshme)	200,250	480	630	
Biletë për personat e moshuar	200	470	800	Nuk ka diferencim për këtë grupmoshë

10. Tarifa e Peshkimit Çlodhës

Referuar ligjit nr. 64/2012 “Për Peshkimin” (i ndryshuar), si dhe duke marrë në konsideratë shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm me nr. prot., 2179 datë 17.01.2023 për vijimin e procedurave mbi përputhshmërinë ligjore të vendimit nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” lind e nevojshme reflektimi i ndryshimeve në vendimin e Këshillit Bashkiak.

Mbështetur në ligjin nr. 64/2012 “Për Peshkimin” neni 40, pika 5 “Autorizimi për peshkimin çlodhës – argëtues” ku shkruhet shprehimisht;

“Autorizimi për peshkimin amator lëshohet nga autoriteti përgjegjës i qeverisjes vendore”

si dhe referuar urdhërit të përbashkët nr. 443, datë 06.10.2022, pika 3, “Për përcaktimin e tarifave të autorizimit për peshkimin çlodhës – argëtues dhe tarifave për shërbimet që ofrohen nga organizatat e peshkimit” të Ministrit të Bujqësisë dhe zhvillimit Rural dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, shkruhet shprehimisht;

Tarifa e autorizimit të peshkimit çlodhës – argëtues në ujëra të brendshëm të jetë 1,000 lekë/vit.

Pika 3 “Të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e autorizimit të peshkimit çlodhës – argëtues do të derdhen në buxhetin e shtetit apo në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me autoritetin përgjegjës që lëshon autorizimin për peshkim”.

Për sa më sipër, Bashkisë Tiranë i lind e drejta të mbledhë kontributin në mjete monetare të subjekteve që kryejnë veprimtarinë e peshkimit çlodhës-argëtues në ujëra të brendshëm dhe për një zbatueshmëri më të mirë po propozojmë një nen të ri në VKB 158/2019 të ndryshuar për këtë tarifë specifike.

“Tarifa për aplikimin e peshkimit çlodhës – argëtues”

Tarifës vendore të peshkimit çlodhës – argëtues në ujëra të brendshëm i nënshtrohen të gjithë personat fizikë, vendas ose të huaj, që kërkojnë të ushtrojnë apo që ushtrojnë aktivitet peshkimi në ujëra të brendshëm.

Për të gjithë qytetaret në territorin e Bashkisë Tiranë, që duan të ushtrojnë peshkimin çlodhës - argëtues nevojitet një autorizim, i lëshuar nga autoriteti përgjegjës i Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. nëpërmjet portalit e-albania.

Autorizimi për peshkimin çlodhës – argëtues përdoret vetëm prej personit, në emër të të cilit është lëshuar.

Mbajtësi i autorizimit, gjatë ushtrimit të aktivitetit çlodhës – argëtues, është i detyruar të mbajë gjithmonë me vete autorizimin përkatës, dhe t’ua tregojë atë personave të autorizuar në bazë të ligjit nr. 64/2012 “Për Peshkimin”, me kërkesën e parë.

Për tu pajisur me autorizimin e sipërcituar, nevojitet ngarkimi në portalin e-Albania i dokumentave të mëposhtëm:

- a) fotografi të aplikantit;
- b) vërtetim anëtarësie në një shoqatë kombëtare të peshkimit çlodhës-argëtues
- c) mandat-pagesa që vërteton pagesën e tarifës.

Detyrimi për tarifën e autorizimit të peshkimit çlodhës – argëtues është vjetor.

Tarifa për “Peshkimin amator në ujëra të brendshëm” është 1,000 lekë/vit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe sipas akt rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat kalojnë 100% në llogarinë e Bashkisë së Tiranës.